REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës:	2020:905340
Datë:	01.10.2021
Numri i dokumentit:	02234117

Ac.nr.2169/18

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Ademi -kryetar i kolegjit, Rrustem Thaqi dhe Zenel Leku, anëtar të kolegjit, me zyrtaren ligjore Biondina Zeneli në çështjen juridike -kontestimore të paditësit N.M. nga Peja, të cilin e përfaqëson me autorizim Z.N., avokat nga Peja, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "E..." në Prishtinë, të cilën e përfaqëson F.SH. me autorizim, për kompensim dëmi në bazë të auto-përgjegjësisë, vlera e kontestit 5000 euro, duke vendosur në lidhje me ankesën e paditësit dhe ankesën e të paditurës të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4/15, i datës 15.03.2018, në seancën jo publike, të mbajtur me datë 22.09.2021, mori këtë:

A K T GJ Y K I M

I. REFUZOHET e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit N.M. nga Peja dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "E..." me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4/15, i datës 15.03.2018, në pikën e III të dispozitivit të aktgjykimit lidhur me shpenzimet e procedurës kontestimore, VËRTETOHET.

II. APROVOHET pjesërisht ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit N.M. nga Peja dhe ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "E..." me seli në Prishtinë, NDRYSHOHET aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.4/15, i datës 15.03.2018, në pikën I, II dhe IV të dispozitivit, dhe gjykohet: DETYROHET e paditura që paditëses në emër të dëmit jo material ti paguaj shumat si në vijim: -në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike për të gjitha llojet shumën prej 3,500 euro, në emër të frikës shumën prej 2,800 euro, për zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 4,100 euro. DETYROHET e paditura që prestimet e cekura nga pika I e dispozitivit të aktgjykimit të atakuar t'ia paguaj paditësit me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 15.03.2018 (data e marrjes së aktgjykimit të shkallë së parë) në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të

2020:905353

përmbarimit me dhunë. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit përtej shumës së aprovuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar C.nr.4/15, i datës 15.03.2018, në pikën I, të dispozitivit ka vendosur që: PJESËRISHT MIRATOHET SI E BAZUAR kërkesëpadia e paditësit N.M. nga Peja dhe DETYROHET e paditura Kompania e Sigurimeve "E..." në Prishtinë Kosovë në që emër të dëmit jo material të shkaktuar paditësit si pasojë e aksidentit i cili ka ndodhur me datë 27.11.2014 rreth orës 17:20, t' ia paguaj shumat e specifikuara si më poshtë dhe atë: I. Për dëmin jo material –në emër të dhimbjeve fizike për të gjitha llojet shumën prej 3000 euro; -zvogëlim të aktivitetit jetësor shumën prej 7700 euro; -në emër të frikës për të gjitha llojet shumën prej 2500 euro. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit ka vendosur që DETYROHET e paditura që prestimet nga pika I e dispozitivit paditësit t'ia paguaj me kamatë ligjore në shumë prej 1063 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënim të përmbarimit. Në pikën III të dispozitivit të aktgjykimi ka vendosur që DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 1063 euro në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi e nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë. Në pikën IV ka vendosur që REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit përtej shumave të aprovuara si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë paraqitur:

-Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën e parashtruar dhe ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, ashtu që aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses dhe të obligohet e paditura që ti paguaj pjesën e refuzuar nga shkalla e parë.

-Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurës për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën dhe aktgjykimin e ta ndryshoj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

-Ankesat janë pjesërisht të themelta.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi, përmes të autorizuarit të tij, me datë 18.04.2015 në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi, të precizuar me parashtresën e datës 16.04.2018 me të cilën ka kërkuar kompensimin e dëmit jo material me arsye si në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të te gjitha shkresave tjera të lëndës ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.4/15, i datës 15.03.2018, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se bazën e kërkesëpadisë e ka vërtetuar nga provat materiale si raporti i aksidentit DR-3004-715-14, i datës 27.11.2014, me procesverbalin e vendit të ngjarjes, skica e vendit të ngjarjes, aksidentit –fotot e automjetit të aksidentuar duke filluar nga faqja e 5 gjerë në faqen e 8 të shkresave të lëndës, raportin mjekësor, udhëzimin nga konsulta e ORL-së, nr.226 i datës 09.01.2018 si dhe nga vetë

2020:905353

deklarimi i të padituri i cili në fjalën e vet përfundimtare nuk e ka kontestuar bazën e kërkesëpadisë, ndërsa lartësinë e kërkesëpadisë gjykata e ka vërtetuar nga ekspertiza mjekësore e ekspertëve, DR. M.B., Dr. A.T., dhe Dr. Sh.M.. Si pasojë e këtij aksidenti paditësi N.M. ka pësuar lëndime të rënda trupore. Paditësi nga pësimi i këtyre lëndimeve kishte përjetuar dhimbje të intensitetit posaçërisht të lartë disa sekonda, dhimbje të intensitetit të lartë në kohëzgjatje prej 7 ditëve, dhimbje të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje prej 4 javëve dhe dhimbje të intensitetit të ulët ka edhe sot, zvogëlim të aktivitetit jetësor ekziston në shkallë prej 11%, ndihna dhe kujdesi i huaj ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 4 javëve, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm në kohëzgjatje prej 4 javëve. Terapia fizikale ka qenë e nevojshme 10 ditë në vitin e parë, 7 ditë në vitin e dytë. Ndërsa sa i përket frikës gjykata ka vërtetuar se paditësi nuk ka përjetuar frikë primare për shkak të humbjes së vetëdijes. Paditësi ka përjetuar vetëm frikë sekondare dhe atë me intensitet të lartë në kohëzgjatje prej një jave, frikë të intensitetit të mesëm në kohëzgjatje preh 4 jave dhe frikë të intensitetit të ulët ka edhe tani.

Bazuar në provat e administruara gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit lidhur me lartësinë e saj është pjesërisht e bazuar andaj kërkesëpadinë e paditësit e ka aprovuar pjesërisht duke u bazuar në dispozitat e nenit 200 al.1 dhe 2 të LMD-së dhe nenit 169 si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit për çfarë shërben ky kompensim si dhe duke u bazuar në të gjitha kriteret dhe masat për caktimin e shpërblimit jo material, e posaçërisht duke marrë për bazë shkallën e dhimbjeve, fizike, frikës dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor prej 11%, të dhënë nga ekspertët e lëmit të mjekësisë, si dhe duke pasur parasysh moshën e të padituri m gjykata pjesërisht e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka caktuar vlerta e shpërblimit të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Lidhur me kamatën gjykata ka vendosur konform nenit 186 dhe 277 të LMD-së dhe dispozitave të nenit 382, duke llogaritur kamatën nga dita e përpilimit të ekspertizës mjekësore me datë 31.01.2018 kur edhe është vërtetuar lartësia e dëmit të shkaktuar në automjet.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka bazuar në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi është ndryshuar.

Kjo Gjykatë vlerëson se me të drejtë paditësi ka konsideruar se shuma e aprovuar nga gjykata në emër të dëmit jo material për dhimbjet fizike është e ulët, për faktin se nga ekspertiza e lëmit të mjekësisë është konstatuar se paditësi ka pësuar lëndime të rënda trupore, dhe në momentin e pësimit të aksidentit i janë shkaktuar dhimbje fizike të intensitetit posaçërisht të rëndë të cilat kanë zgjatur disa sekonda, deri në humbjen e vetëdijes, ndërsa dhimbje të intensitetit të rëndë ka pasur për 7 ditë, duke pasur parasysh edhe politraumën dhe dy hospitalizime, dhimbje këto që janë shfaqur kohë pas kohe nën veprimin e terapisë. Ekspertët po ashtu, kanë konstatuar se paditësi ka pasur dhimbje fizike të intensitetit të ulët për 4 javë, kohë e cila është e nevojshme për heqjen e hematomave, e dëmtimit të indeve të bua, inflamacionit post traumatik nën veprimin e terapisë.

Duke pasur parasysh mendimin e ekspertëve, Gjykata e Apelit vlerëson se shuma e aprovuar nga gjykata e shkallës së parë në emër të dhimbjeve fizike për të gjitha llojet është e ulët në raport me dhimbjet e përjetuara, apo nën nivelin e duhur në raport me lëndimet e shkaktuara, por njëkohësisht të ulëta edhe në raport me praktikën gjyqësore, ndërsa shuma e aprovuar në raport me zvogëlimin e aktivitetit jetësor është tejet e lartë dhe në disproporcion me praktikën

2020:905353

gjyqësore. Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për kategoritë e dëmit jo material dhe atë: për dhimbjet fizike, frikë dhe zvogëlimin e aktivitetit jetësor pasi që vlerësoj se shumat e gjykuara nuk ishin në përputhje me qëllimin të cilit i shërbejnë kompensimit. Në çdo rast për dëmin jo material, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimit të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi tu shkoj përshtati qëllimeve që synohen me kompensimin e dëmit jo material e që është satisfaksion për të dëmtuarin. Mbi këtë bazë Gjykata e Apelit duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësi, llojin dhe kohëzgjatjen e dhimbjeve fizike si dhe praktikën e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 183 të LMD-së, vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit vlerëson se e paditura ka të drejtë lidhur me kompensimin e dëmit jo material lidhur me zvogëlimin e aktivitetit jetësor, kur konsideron se shuma është tejet e lartë, ku nga mendimi i ekspertëve është konstatuar se paditësi ka pësuar zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm në shkallë prej 11%, ku ky zvogëlim manifestohet me ecje ndonjëherë të disekuilibruar, dhembje koke, lodhje gjatë qëndrimit me të gjatë dhe ecjeve më të gjata që i është përcjellë edhe me kufizim të lëvizjeve të shputës së majtë në shkallë më të lehtë si pasojë e thyerjes.

Gjykata e Apelit ka çmuar se aktgjykimi duhet ndryshuar edhe sa i përket kamatës sepse gjykata e shkallës së parë gabimisht kishte aplikuar të drejtën materiale, prandaj Gjykata e Apelit ka vendosur si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, e duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë 15.03.2018, e deri në pagesën definitive, sepse pala paditëse për dëmin dhe lartësinë e tij, ka ra në dijeni në momentin kur gjykata e shkallës së parë ka vendosur dhe nga ai moment kërkesa e tij për kompensim dëmi është bërë e kërkueshme dhe konsiderohet se e paditura ka ra në vonesë për përmbushjen e detyrimit.

Gjykata e Apelit i vlerësoi edhe pretendimet e tjera ankimore, mirëpo vlerësoi se të njëjtat janë të pa bazuara dhe nuk kanë ndikim për vendimmarrje ndryshe nga ai sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e paraqitura me lartë e në pajtim me nenin 194, 195 paragrafi 1 pika d) dhe e), e lidhur me nenin 201 paragraf 1 pika d) të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.2169/18, me datë 22.09.2021

Kryetari i kolegjit
Faton Ademi